




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, kk.rks-gov.net/gjilan, info.gjilan@rks-gov.net tel. 0280 320 781, 0280 320 782, 321 482, 321 483

Në mbështetje të nenit 38 paragrafi 1.4 të Statutit të Komunës së Gjilanit 01. nr. 16-126211 dt. 06.11.2014, dhe në zbatim të nenit 6 paragrafi 3 të Rregullore për ndarjen e Subvencioneve 01.Nr.016-144327 të datës 30.12.2014, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në mbledhjen e mbajtur me 27.01.2015, merr:

V E N D I M

Për ndarjen e mjeteve financiare për Subvencionim e aktiviteteve të Shoqatës së të Verbërve në Gjilan

1. Me këtë vendim ndahen mjetet financiare në shumën prej 5500.00 € (pesëmijë e pesëqind euro) për subvencionim të aktiviteteve të Shoqatës së të Verbërve në Gjilan për vitin 2015.
2. Shoqata është e obliguar që të paraqes projekt propozimin në të cilin duhet të përshkruhen aktivitetet me agjendë të planifikuar dhe të specifikuar në mënyrë financiare.
3. Shoqata është e obliguar që të bëjë përmbylljen mjeteve të shpenzuara dhe për këtë të ofroj dëshmi në mënyrë që të përfitoj nga ky subvencionim
4. Mjetet financiare ndahen nga Buxheti i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale -kategoria e shpenzimeve të Subvencioneve.
5. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset ekzekutivi i Komunës, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset Kryesuesi i KK-Gjilan.
6. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës,

01. Nr. 016-9259
Gjilan, më 27.01.2015

Kryesuesja e Kuvendit,

Valentina Bunjaku-Rexhepi